



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7665/ Prot. 11

Elbasan, më 27.11.2018

VENDIM

Nr. 144 Datë: 27.11.2018

**“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, NË BASHKINË
ELBASAN, PËR VITIN 2019”**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ .11.2018, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Elbasan, për vitin 2019”, si dhe relacionin dhe propozimet e Komisionit të Ekonomisë së Këshillit Bashkiak, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- Ligjin nr.9482 datë 03.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.10465 datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9975 datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9385 datë 04.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9693 datë 19.3.2007 “Për fondin kullësor”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.10296 datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- VKM nr.433 datë 08.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së

- Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Bashkia, për netë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
- Në rastet kur subjektet nuk mbajnë regjister të klientëve që flejnë në hotel, administratës tatimore i lind e drejta të bëjë vlerësimin.
- Afati për pagesën e kësaj takse është data **31.10.2019**.
- Për mospagesë në afatin e caktuar aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj, deri në 12 muaj mbi detyrimin.

Struktura të caktuara për vjeljen e kësaj takse janë Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave.

Tabela C - Taksa e ndikimit në infrastrukturë

	Emërtimi	Niveli i taksës
a.	Strukturë banimi: 1. ndërtime për banim e shërbim me qëllime fitimi nga firmat e ndërtimit.	4% e çmimit të shitjes në fuqi sipas U.K.M. përkatëse të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
	Strukturë banimi: 2. për ndërtime për banim e shërbime nga investitorë të tjerë për qëllime jo fitimi.	3% të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
b.	Ndërtime të karakterit ekonomik, turizëm, industrial (magazinë, reparte prodhimi, antena, vendosje reklamash)	3 % e preventivit real të investimit, më çmimet në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
c.	Strukturë për qëllime publike, përjashtohen investimet e Bashkisë Elbasan.	2 % të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
d.	Rehabilitim rrugësh, ujësjellësash, kanalizimesh, përjashtuar Bashkinë Elbasan.	2 % e vlerës së investimit sipas të preventivit me çmimet në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
e.	Struktura me funksion privat (prodhime, tregtimi e shërbimi).	3% të vlerës së investimit sipas çmimit të Entit të Banesave në fuqi.
f.	Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0.1% të vlerës të preventivit në bazë të manualit të ndërtimit në fuqi.
g.	Për ndërtesat në proces legalizimi.	0.5% e vlerës së investimit në bazë të çmimit të Entit Kombëtar të Banesave në fuqi.
h.	Për ndryshim funksioni.	3% e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.

i.	Rikonstruksione e struktura të ndryshme.	3% e vlerës së preventivit në bazë të manualit të ndërtimit.
j.	Për individët që trajtohen nga emergjencë civile për rrëshqitje të tokës ose nga fatkeqësi të tjera natyrore.	0%
k.	Objekte që zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si agro-turizem sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.	0 %

Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela C/1 - Taksë për objektet në proces legalizimi

	Kategoritë dhe nënkategoritë për më tepër se një (1) objekt në proces legalizimi	Përqindja e ndikimit në infrastrukturë
1.	Struktura banimi.	3% e ndikimit në infrastrukturë
2.	Struktura me funksione shërbimi dhe administrative.	3% e ndikimit në infrastrukturë
3.	Struktura për qëllime publike si: shkolla, kopshte, spitale etj., (private ose publike).	2% e ndikimit në infrastrukturë

- Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit.
- Dokumentacioni i kërkuar do të jetë ai i parashikuar nga drejtoria përkatëse, i cili përfshin kopje të njehësuar të vetëdeklarimit, planvendosje të objektit, si dhe planimetritë me sipërfaqjet përkatëse.

Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela C/2 - Vendosja e garancisë financiare për heqjen e inerteve

Garancia financiare për heqjen e inerteve	% e vlerës së strukturës së objektit
Garancia financiare për heqjen e inerteve.	3% e vlerës së investimit sipas strukturës së objektit

- 3
- Në mbështetje të pikës 10, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të Bashkisë Elbasan, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit.

Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve.

Tabela D - Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

Nr.	Kategoritë e ndërtesave	Niveli tregues i taksës (Qyteti Elbasan) lekë/m ²	Njesitë Administrative lekë/m ²
1.	Ndërtesa banimi.	300	100
2.	Ndërtesa për tregti e shërbime.	700	300
3.	Ndërtesa të tjera.	500	200

- Kjo taksë vendoset për rastet e transferimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
- Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.
- Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%.
- Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
- Pagesa e taksës së çdo ndërtimi fillon nga momenti i marrjes së lejes së shfrytëzimit, si detyrim i ndërtuesit. Me paraqitjen e kontratave të shitjes prej tij, detyrimi i lind subjektit blerës të sipërfaqjes së ndërtimit.

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit të Bashkisë Elbasan, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Tabela E - Taksa për vendosjen e tabelës

Kategoritë	Njësia matëse	Niveli i taksës Qyteti	Niveli i taksës Njësitë administrative

	kur kërkohet nga organet e prokurorisë, të gjykatës ose nga vetë shtetasit, personat juridike e fizike, vendas e të huaj.		
6.	Tarifa e ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve nga shërbimi i MZSH- së në objektet e siguruara nga zjarri nga shoqëritë e sigurimit.	lekë/orë ndërhyrje	15,000

- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (M.Z.SH.) rregullohet nga ligji nr. 152/2015 "Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
- Tarifat në lidhje me shërbimet e MZSH-së përcaktohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 12.10.2016 "Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 9.11.2016 "Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara nga zjarri dhe administrimin e përdorimin e të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor MZSH-së".


Struktura e caktuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria Vendore e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, pranë Bashkisë Elbasan.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi në 01.01.2019.

Konceptoi:

Zv /Kryetar i Bashkisë: Klevis Xhoxhi
 Drejtoria Juridike: Ornela Deliallisi
 Drejtoria e P.P.A.A.B.F: Qemal Tushta
 Drejtoria e Përgj. Shërbimeve Organizative: Bardhul Çabiri
 Drejtoria e Përgj. Shërbimeve Operacionale: Etleva Kënuti
 Drejtoria e Kordinimit me Njësitë Administrative: Shefqet Bullari
 Agjensia e Shërbimeve Publike: Irland Sina
 Agjensia e Shërb. Pyjore, Bujqësore, Veterinare, Mjedisore: Shpëtim Çullhaj
 Avokati i Qytetit: A. Hoxha

Sekretari i Këshillit Bashkiak
 Klajd Gripshi



Kryetari i Këshillit Bashkiak
 Altin Idrizi

